



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

# BARAZIA NË FOKUS

*Gazetë e ilustruar, Nr. 2, Prizren, 2025*





*Mybexhele Zhuri, udhëheqëse e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore pranë Komunës së Prizrenit*



*Nga e majta në të djathtë: Kaltrina Dakaj, zyrtare e DKA, Nancy Soderberg, Drejtoreshë e NDI në Kosovë dhe Luljeta Veselaj-Gutaj, Drejtoreshë e DKA, Prizren*



*Shykran Berisha, Drejtoreshë e Asociacionit të Gruas "Feminae", Prizren*



*Lulzim Drini, Drejtor i Institutit Parashkollor "ZAMBAKU", PRIZREN*



*Antigona Shestan, Organizata e Personave me Distrofi Muskulare*



*Lule e kopshteve prizrenase*



*Lule të qëndisura*



*Lule e kopshteve prizrenase*

## PËRMBAJTJA:

## BARAZIA NË FOKUS

Gazetë e ilustruar  
Nr. 2, Prizren, 2025

### EDITORIAL

- 3 Editorial
- 4-5 Mybexhele Zhuri, Veprimtaria e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore pranë Komunës së Prizrenit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
- 6 Mybexhele Zhuri, Arritjet e Komunës së Prizrenit në fushën e Barazisë Gjinore në kuadër të Planit Lokal për Barazi Gjinore
- 7 Dhuna me bazë gjinore
- 8-9 Veprimtaria e OJQ “Handikos”, Prizren
- 10 Veprimtaria e Drejtorisë së Shëndetësisë pranë Komunës së Prizrenit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
- 11 Veprimtaria e Njesisë për Komunikim dhe Publikim pranë Komunës së Prizrenit & Veprimtaria e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pranë Komunës së Prizrenit
- 12-13 Histori suksesi -Tringë Kasemi
- 14 Histori suksesi -Ater Koro Arifi
- 15 - 18 Ilustrimet
- 19 Faqja e fëmijëve-Veprimtaria, struktura dhe aktivitetet e Institucionit parashkollor “Zambaku” Prizren
- 20-21 Veprimtaria e Organizatës ”OPDMK”, Prizren në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
- 22-23 Indira Elshani, OJQ „SAKUNTALA“, Prizren
- 24 Veprimtaria e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës pranë Komunës së Prizrenit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
- 25 Veprimtaria e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit pranë Komunës së Prizrenit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
- 26-27 Shpresë Siqeca, Faqja e kulturës & Faqja e trashëgimisë kulturore
- 28 Shykran Berisha, “Plisi, tirqit dhe opingat”
- 29-30 Lajme Info

Tematika bosht e gazetës “Barazia në Fokus” është promovimi i barazisë gjinore në Prizren. Gazeta përpiket të ngrisë zërin e femrës prizrenase në zbatimin e ligjeve të barazisë gjinore sipas standardeve evropiane. Numri 2 i Gazetës “Barazia në Fokus” fokusohet në aktivitetet rreth barazisë gjinore të realizuara në Prizren gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025. Bën fjalë kryesisht për veprimtarinë e Komunës së Prizrenit, Njesisë për të Drejtat e Njeriut NJDNJ dhe Zyres për Barazi Gjinore, në promovimin e barazisë gjinore. Në këtë numër përfshihen edhe veprimtaritë e disa Drejtorive Komunale. Pasonjë informacione mbi aktivitetet e disa OJQ-ve të qytetit që mirren me barazi gjinore, me Persona me Aftësi të Kufizuara dhe me artizanatet e grave. Një rëndësi e veçantë u kushtohen aktiviteteve gjatë muajit Tetor, muaji i luftës kundër kancerit të gjirit, Ditës Ndërkombëtare të PAK, si dhe aktiviteteve gjatë muajit Dhjetor, gjatë 16 ditëve të Fushatës Mbarëbotërore kundër Dhunës ndaj Grave dhe Fëmijëve. Vlen të theksohet rubrikat Histori suksesi që afirmon femrat që mirren me aktivizëm qytetar, me kulturë, art apo artizanate. Pason rubrika për fëmijë, që bën fjalë për një çerdhe publike të qytetit. Gazeta ofron lajme nga kultura, trashëgimia kulturore dhe panairët e artizanateve. Ilustrimet janë pjesë e gazetës, të cilët, padyshim e begatojnë atë. Urojmë që gazeta të ketë lexueshmëri dhe jetëgjatësi edhe në vitet në vijim.

**Botimi i Gazetës u mundësua nga Komuna e Prizrenit: Drejtorja e Administratës Komunale**

**Kryeredaktore:** Shpresë Siqeca

**Bashkëpunuan:** UN WOMEN, Disa Drejtori të Komunës së Prizrenit, Institucioni parashkollor “Zambaku”, Prizren dhe disa OJQ të qytetit.

**Autorët e shkrimeve:** Mybexhele Zhuri, Shpejtim Rramanaj, Jakup Kastrati, Antigona Shestan & Resmija Rahmani, Merita Shala, Indira Elshani, Tringë Kasemi, Ater Koro Arifi, Shykran Berisha, Shpresë Siqeca

**Shtypi:** BES Print, Prizren

# VEPRIMTARIA E NJËSISË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZISË GJINORE PRANË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Mybexhele Zhuri

## RËNDËSIA E FUQIZIMIT TË GRAVE ZYRTARE KOMUNALE

Fuqizimi i grave zyrtare komunale nga të gjitha komunitetet ka rëndësi për nxitjen e qeverisjes jo vetëm më transparente dhe llogaridhënëse por edhe më përfshirëse, e barabartë për të gjithë qytetarët dhe qytetarët në proceset vendimmarrëse.

Gratë zyrtare në nivel komunal kanë një rol të pazëvendësueshëm në ndërtimin e politikave që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. Fuqizimi i tyre, dhënja e hapësirave për pjesëmarrje aktive, si dhe bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve, përbëjnë shtyllat kryesore për një shoqëri më demokratike dhe më gjithëpërfshirëse.

Në këtë kuptim, **fuqizimi i grave zyrtare në nivel komunal është thelbësor**, sepse gratë janë bartëse të ndryshimeve pozitive, zëra të arsyes dhe vizionare për politika që reflektojnë nevojat reale të qytetarëve dhe qytetarëve.

Në këtë mënyrë ndikohet drejtpërdrejtë në barazinë, luftimin e dhunës, që kohëve të fundit, bazuar në raportime, e shohim si sfidë të madhe edhe për krijimin e politikave më të drejta dhe më të qëndrueshme.

Kur gratë dhe burrat, nga të gjitha komunitetet, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, ne mund të krijojmë institucione më të forta, më transparente dhe më afër qytetarëve.

Çdo ide, çdo iniciativë, çdo vendim që merret është pjesë e ndërtimit të një kulture ku zëri i gruas është i barabartë dhe i domosdoshëm dhe ndikon në ndërtimin e një kulture të re të qeverisjes së barabartë.

Rruga e secilës grua drejt Asamblesë komunale është dëshmi e guximit, përkushtimit dhe fuqisë së brendshme që bart ajo. Gratë Asambleiste janë shembull për vajzat dhe gratë e komunitetit, një dëshmi e qartë se barrierat thyen kur vizioni dhe vullneti janë më të forta se paragjykimet.

Vendi i tyre në tavolinat e vendimmarrjes nuk është rastësi - është fitore e merituar. Çdo hap që bëjnë, çdo vendim që ndërmarrin dhe çdo zë që ngrisin, ndikon në të sotmen dhe të ardhmen e qytetarëve dhe qytetarëve.

Kosova ka një kornizë shumë të mirë ligjore për barazi gjinore - Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin kundër Diskriminimit, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe kuota të përfaqësimit në asamblëtë komunale.

Megjithatë, zbatimi praktik shpesh nuk e arrin nivelin që parashikohet me ligj.

Ka komuna që dallohen për iniciativa të mira (p.sh. programe për fuqizimin ekonomik të grave, plane lokale të barazisë gjinore), por ka edhe komuna ku barazia gjinore trajtohet formalisht, vetëm për të plotësuar kërkesat ligjore.

## SFIDAT KRYESORE

Ne akoma ballafaqohemi me mentalitetin patriarkal - mentaliteti patriarkal akoma ndikon në vendimmarrje:

Gratë marrin më pak pjesë në procese buxhetore dhe planifikim lokal;

- Punësimi në sektorin publik lokal shpesh mbetet i pabarabartë;
- Kemi mungesë të mekanizmave efektive të raportimit të diskriminimit;

Mund të themi se Barazia respektohet pjesërisht, por jo në nivel të kënaqshëm. Ligjet janë moderne, ndërsa zbatimi në praktikë mbetet i dobët dhe i pabarabartë mes komunave.

Komunat kanë përmirësime, por ende ka shumë hapësirë për progres real në përfaqësim, punësim, vendimmarrje dhe qasje të barabartë në shërbime.

## VEPRIMTARIA E NJËSISË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZISË GJINORE PRANË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Mybexhele Zhuri

### GJENDJA E BARAZISË GJINORE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit ka hartuar **Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026**, që synon të përfshij politika lokale, role dhe përgjegjësi për institucione dhe shoqëri civile. Ky plan është një mjet praktik për të zbatuar angazhimet ligjore dhe ndërkombëtare në nivel lokal. Komuna e Prizrenit është mes disa komunave që kanë bashkëpunuar me **UN Women** për integrimin e perspektivës gjinore në buxhete komunale (GRB) dhe po zhvillon projekte që fuqizojnë rolin ekonomik të grave. Kjo tregon një angazhim institucional për të pasur politika buxhetore ku merren parasysh nevojat gjinore.

Janë bërë analiza gjinore në tre drejtori të Komunës së Prizrenit: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria Komunale e Arsimit. Analizat gjinore do të vazhdojnë edhe në drejtori të tjera të Komunës së Prizrenit. Ka shumë iniciativa lokale që promovojnë fuqizimin ekonomik të grave.

**Komuna, përmes Zyres për Barazi Gjinore bashkëpunon me:** Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ); Policinë e Kosovës në Prizren për çështje të domosdoshme si dhuna në familje dhe zbatimi i legjislacionit relevant;

Komuna ka një vëmendje institucionale ndaj problemeve serioze gjinore. **Mirëpo mos të harojmë se barazinë e bëjnë angazhimi i gjithë grave dhe burrave.**

Në Komunën e Prizrenit, barazia gjinore është e respektuar-ka hapa konkrete për përmirësim dhe ka angazhim institucional, por nuk është arritur akoma niveli i duhur dhe i qëndrueshëm, sidomos sa i përket udhëheqjes dhe vendimmarrjes.

Për të konsoliduar barazinë gjinore, do të nevojitet: Zbatim më aktiv i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore; Më shumë angazhim politik për pozita udhëheqëse për gratë; Monitorim dhe llogaridhënie të mekanizmave brenda komunës (drejtori, komitete); Investim në buxhet me perspektivë gjinore; Bashkëpunim i vazhdueshëm me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare për projekte të fuqizimit ekonomik të grave etj; Ngritja e nivelit të sigurisë dhe mbështetja e nevojshme për viktimat e dhunës në baza gjinore;

### TAKIM ME NXËNËS TË SHKOLLAVE FILLORE TË PRIZRENIT PËR ORIENTIM DREJT ARSIMIT PROFESIONAL



Komuna e Prizrenit, në kuadër të **Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore** në përkrahje nga projekti

“Gender Equality Facility” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UN-Women, Kosovë, mbajti aktivitetin: **“Takim informues me nxënëset dhe nxënësit në shkolla për t’i orientuar drejt arsimit profesional dhe profesioneve që thyejnë stereotipet gjinore”**.

Ky aktivitet kishte për synim t’i ndihmojë të rinjtë të reflektojnë mbi aspektet e ndryshme të përzgjedhjes së karrierës, të motivohen dhe ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e zgjedhjes së karrierës dhe të frymëzohen për të ndjekur fusha që thyejnë stereotipat gjinore, veçanërisht vajzat në STEM.

Në këtë aktivitet morën pjesë nxënëset dhe nxënësit e klasave të nënta të shkollave fillore të mesme të ulëta “Emin Duraku” dhe “Hysen Rexhepi” nga Prizreni.



## ARRITJET E KOMUNËS SË PRIZRENIT NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE NË KUADËR TË PLANIT LOKAL PËR BARAZI GJINORE

### Mybexhele Zhuri

Komuna e Prizrenit, e udhëhequr nga parimet e barazisë gjinore, përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, ka shënuar përparim të qëndrueshëm në avancimin e barazisë gjinore, në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin Lokal për Barazi Gjinore. Ky plan shërben si dokument udhërrëfyes për veprimet institucionale dhe si bazë për harmonizimin e politikave lokale me legjislacionin në fuqi, si dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Një nga arritjet kryesore është forcimi i mekanizmave lokale për barazi gjinore, përfshirë Zyren për Barazi Gjinore, e cila ka rol kyç në koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit Lokal për Barazi Gjinore.

Përmes këtyre mekanizmave, perspektiva gjinore është integruar në dokumentet strategjike komunale, në planet vjetore të punës dhe në proceset e planifikimit buxhetor, duke kontribuar në zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, siç parashihet në plan.

Në kuadër të objektivave të Planit Lokal për Barazi Gjinore për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë masa konkrete për promovimin e përfaqësimit të barabartë në administratë, në pozita udhëheqëse dhe në trupat këshillëdhënëse. Paralelisht, janë zbatuar aktivitete që synojnë fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë trajnime profesionale,

programe të vetëpunësimit, mbështetje financiare dhe bashkëpunim të strukturuar me organizatat e shoqërisë civile, në përputhje me shtyllën për zhvillim ekonomik dhe punësim të barabartë.

Një fokus i veçantë i Planit Lokal për Barazi Gjinore është parandalimi dhe luftimi i dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje. Në këtë drejtim, Komuna e Prizrenit ka zbatuar fushata vetëdijësuese, ka forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ka mbështetur mekanizmat e mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave, duke siguruar zbatim të koordinuar të politikave dhe përgjegjësi të përcaktuara në plan.

Në aspektin e përfshirjes sociale dhe qasjes së barabartë në shërbime publike, janë realizuar masa që adresojnë nevojat e grave nga grupet e marginalizuara, gratë nga zonat rurale, komunitetet jo-shumicë dhe gratë me aftësi të kufizuara. Këto veprime pasqyrojnë përkushtimin e Komunës së Prizrenit për zbatimin e mos-diskriminimit dhe barazisë, siç është e paraparë në Planin Lokal për Barazi Gjinore. Përmes zbatimit të këtij Plani, Komuna e Prizrenit ka krijuar një kornizë funksionale për avancimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Komuna mbetet e përkushtuar për monitorimin e vazhdueshëm, vlerësimin e rezultateve dhe përditësimin e politikave, me qëllim të ndërtimit të një shoqërie më të drejtë, më të barabartë dhe më gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët.

# DHUNA ME BAZË GJINORE

## FUSHATA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE



Me datën  
**25.XI.2025,**  
Komuna e  
Prizrenit shpalli  
hapjen zyrtare të  
Fushatës Kundër  
Dhunës në Familje  
dhe Dhunës me  
Bazë Gjinore

**Kjo fushatë ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe krijimin e një komuniteti të sigurt për çdo qytetar.**

**Përmes aktiviteteve informuese, takimeve me qytetarë dhe bashkëpunimit me institucionet lokale, Komuna synon të promovoj zero tolerancë ndaj çdo forme të dhunës dhe të ofroj mbështetje konkrete për personat e prekur.**

**Komuna i ftoi të gjithë qytetarët, institucionet arsimore, shëndetësore dhe organizatat lokale të bashkohen në luftimin e dhunës, për një shoqëri më të drejtë dhe më të sigurt.**



*Komunikatë e  
Komunës së  
Prizrenit*

## TAKIMI I MEKANIZMIT KOORDINUES ME TEMATIKË TË DHUNËS NË FAMILJE

Në Prizren është mbajtur takimi i rregullt, përmbyllës për vitin 2025, i mekanizmit koordinues me akterët që merren me trajtimin e rasteve dhe veprave penale të dhunës në familje, brenda kompetencës së Prokurorisë Themelore në Prizren.

Takimi u organizua nga prokurorja dhe koordinatorja për rastet e dhunës në familje znj. Mehreme Hoxha, me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE-Misioni në Kosovë.


Takimi mbledhi së bashku prokuroren/koordinatoren znj. Elfete Purova, përfaqësues nga Gjykata Themelore e Prizrenit, Policinë e Kosovës-Rajoni i Prizrenit, përfaqësues nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimi Sprovues, mbrojtës të viktimave, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Zyra për Ndihmë Juridike Falas, Spitali i Prizrenit, Zyrtarja e NJDNJ dhe Barazisë Gjinore pranë Komunës së Prizrenit, si dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit/et vlerësuan lartë nivelin e bashkëpunimit ndër-institucional në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke evidentuar të arriturat, por edhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë punës së përditshme.

Drejtori i Policisë Rajonale në Prizren, kolonel Faton Alija, si dhe gjykatës, zyrtarë policorë dhe përfaqësues të tjerë institucionalë, theksuan sfidat që shoqërojnë trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë rastet e viktimave të ndjeshme, viktimat e përsëritura dhe vështirësitë operative gjatë hetimit dhe mbrojtjes së tyre.

## VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS JOQEVERITARE „HANDIKOS“ PRIZREN

*Merita Shala*



**Aktivitetet e  
Merita Shalës  
NË HANDIKOS  
PRIZREN:**

**Merita**  
Shala është një  
aktiviste dhe  
udhëheqëse e  
përkushtuar në  
fushën e të  
drejtave dhe

rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara. Që nga viti 2016, ajo ka filluar angazhimin e saj në OJQ “HANDIKOS” PRIZREN si edukatore joformale me fëmijët me aftësi të kufizuara, në kuadër të një projekti të mbështetur nga Save the Children.

Gjatë këtij rrugëtimi, Merita ka ndjekur trajnime të shumta profesionale, duke ndërtuar kapacitete të qëndrueshme në ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese. Si rezultat i këtij angazhimi dhe përkushtimi, në vitin 2018 ajo ka arritur të licencojë Qendrën “HANDIKOS” PRIZREN, e cila vazhdon të jetë e licencuar edhe sot.

Që nga viti 2021, Merita Shala ka marrë nën udhëheqje OJQ “HANDIKOS” PRIZREN. Nën drejtimin e saj, shërbimet për personat me aftësi të kufizuara asnjëherë nuk janë ndalur, pavarësisht sfidave financiare apo mungesës së projekteve. Ajo dhe stafi i saj kanë qëndruar gjithmonë pranë grupeve më të marginalizuara, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në komunitet.

Sot, OJQ “HANDIKOS” PRIZREN është qendra më e madhe rehabilituese në Prizren dhe e vetmja OJQ në këtë komunë që ofron pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara. Ky sukses është rezultat i përkushtimit, punës së palodhur dhe vullnetit të Meritës, si dhe mbështetjes së vazhdueshme nga donatorët dhe një staf i përkushtuar e i palodhur.

Megjithatë, puna nuk ka përfunduar. Nevojat vazhdojnë të jenë të mëdha dhe nevojitet mbështetje e mëtejme për të zgjeruar dhe vazhduar shërbimet, në mënyrë që asnjë person me aftësi të kufizuara të mos mbetet pa përkrahje.

### **Historiku: OJQ “HANDIKOS” PRIZREN**

*Fuqizimi i Personave me aftësi të kufizuara dhe gjithëpërfshirja e tyre në shoqëri.*

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1983, Ajo përfaqëson e përkrah personat me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar për të drejtat dhe liritë e tyre dhe duke ofruar shërbime rehabilituese dhe sociale, me qëllim të përmbushjes së nevojave për të arritur të drejtat e barabarta, jetë të pavarur dhe të dinjitetshme drejtë pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN do të punojë drejtë arritjes së një shoqërie gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara. Për të arritur këtë, OJQ “HANDIKOS” PRIZREN ka vendosur dy objektiva kryesore:

- Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale të vetëqëndrueshme të bazuara në bashkësi për persona me aftësi të kufizuara;
- Avancimi i të drejtave për lëvizje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, mirëqenie sociale arsim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara.

**Misioni:** Përfaqësimi dhe përkrahja e personave me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar dhe duke ofruar shërbimet e rehabilitimit të bazuar në komunitet për të arritur të drejta të barabarta, për një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë.

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN e ka fokusuar punën e tij në pesë lloje të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet: (1) Rehabilitim primar fizik dhe psiko-social; (2) Shërbime të qëndrimit ditor; (3) Shërbime të ofruara në shtëpi; (4) Shërbime për jetë të pavarur; (5) Shërbime për pajisje ndihmëse; Këto shërbime deri më tani janë financuar nga donatorë të ndryshëm: Save the Children/Kosova, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qeveria komunale.

**Fushëveprimtaria:** 1. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara; 2. Ofrimi i shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara; 3. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në jetën publike.

# VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS JOQEVERITARE „HANDIKOS“ PRIZREN

## *Merita Shala*

### SFONDI DHE STRUKTURA E ORGANIZATËS

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN, edhe pse zyrtarisht e themeluar më 04.12.2015, realizon programe dhe eksperiencë që datojnë që nga viti 1980, kur shërbente si shoqatë e invalidëve, e cila përfaqësonte të gjitha llojet e personave me aftësi të kufizuara PAK.

Nga viti 1999-2015, OJQ “HANDIKOS” PRIZREN ka shërbyer si degë e organizatës “HANDIKOS” KOSOVA, ndërsa nga 04.12.2015, është regjistruar si OJQ lokale, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për PAK në nivel lokal.

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN ka marrëveshje mirëkuptimi me organizatën “HANDIKOS KOSOVA”, dhe disa nga projektet e saj implementohen nga “HANDIKOS” PRIZREN.

Qëllimi i marrëveshjes së mirëkuptimit, si dhe implementimi i këtyre projekteve është avancimi i të drejtave të njeriut të PAK në gjithëpërfshirje në shoqëri.

Organizata operon me një staf profesional, ku 4 prej tyre janë të licencuar nga ana e MPMS, në bazë të kësaj konsiston se stafi është i obliguar të ofroj shërbime për PAK.

Gjatë gjithë këtyre viteve OJQ “HANDIKOS” PRIZREN ka ofruar shërbime për PAK dhe ka arritur të krijoj besueshmëri tek komuniteti për cilësinë e shërbimeve. Me vetë faktin se organizata ka eksperiencë të gjatë në këtë fushë, nënkupton se shërbimet nuk kanë qenë të përkohshme dhe janë pjesë e planeve afatgjata.

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN ka një përvojë të gjatë dhe solide në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar shërbime të përgjithshme të rehabilitimit të bazuara në komunitet (CBR) që nga viti 1999, në të cilat ka pilotuar dhe ofruar një sërë modelesh të shërbimeve sociale të bazuara në bashkësi, duke bërë vizita në shtëpi dhe referime, duke ofruar pajisje ndihmëse, duke këshilluar të rriturit me aftësi të kufizuara për vetë - kujdes dhe jetë të pavarur.

OJQ “HANDIKOS” PRIZREN është e vetmja organizatë në komunë e cila ofron shërbime cilësore me profesionalizëm, si dhe mjete ndihmëse sipas nevojës për PAK.

Stafi i OJQ “HANDIKOS” PRIZREN është i trajnuar nga shumë agjenci/organizata të ndryshme, për ofrimin e shërbimeve:

Handikap Internacional (Francë);  
Don Gnocchi (Itali);  
ICACBR Queens University (Kanada);  
Save The Children (Itali);  
Finish Ministry of Foreign Affairs (FIDIDA) nga Finlanda, Britania e Madhe, Italia;  
Save The Children, për ngritje të kapaciteteve të stafit në programin e RBB etj.

Partnerët aktual që janë duke i përkrahur Qendrat e Bazuara në Komunitet / Save the Children, në vazhdimësi po sugjerojnë se ky partneritet mund të vazhdojë vetëm nëse OJQ “HANDIKOS” PRIZREN arrin të bashkëfinancojë, së bashku me qeverinë qendrore dhe lokale.

### PLANI I PUNËSIMIT:


- **Menaxher i Qendrës**
- **Psikolog**
- **Fizioterapeut**
- **Edukator**
- **Bordi**
- **Kuvendi i Anëtarëve**

Shërbimet që ofrohen në qendrën e RBB së (Rehabilitimi i Bazuar në Bashkësi) me fokus fëmijët me aftësi të kufizuara:

- **Rehabilitimi primar fizikal**
- **Rehabilitimi psiko social**
- **Parandalimi i konsekuencave si rezultat i aftësisë së kufizuar**

## VEPRIMTARIA E DREJTORISË KOMUNALE TË SHËNDETËSISË NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025

*Shpejtim Rramanaj, Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë*



Në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025 zyrtarë nga DKSH kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme për ndërgjegjësimin

kundër diskriminimit në baza gjinore. Me datë: 14.11.2025, pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët, organizuar nga OSCE, lidhur me ngritjen e mbështetjes përmes subvencionimit për gratë në Komunën e Prizrenit. Më: 25.11.2025, organizuar nga zyra për qeverisje të mirë, trajnim për "Ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin kundër diskriminimit në baza gjinore". Më 04.12.2025, organizuar nga Medica Gjakova, takim në cilësinë e anëtarit të komitetit drejtues të programit "Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj stresit dhe traumës për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale".

Drejtorja e Shëndetësisë nuk subvencionon projekte por vetëm individë me sëmundje të rënda, përfshirë të gjitha llojet e kancerit. Brenda vitit 2025, janë subvencionuar dhe janë në procedurë mbi 1200 persona, ku rreth 70% e tyre kanë qenë gra.

Gjatë muajit tetor (Muaji Rozë), Drejtorja e Shëndetësisë, përmes Qendrës Komunale të Mjekësisë Familjare QKMF "Dr.NEXHIP BERISHA", ka realizuar një sërë aktivitetesh në kuadër të fushatës për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës. Me datë: 01.10.2025, është realizuar marshi senzibilizues nga QKMF deri tek sheshi i Lidhjes, ku përmes një aktiviteti me të ftuar dhe qytetarë, është bërë hapja zyrtare e Muajit Rozë, prezantimi i aktiviteteve, prezantimi i broshurës ndërgjegjësuere për vetëdijësim dhe edukim për kancerin e gjirit. Më 02.10.2025, është mbajtur ligjëratë ndërgjegjësuere për kancerin e gjirit në sallën e trajnimeve në QKMF. Më 08.10.2025, vizitë solidarizuese organizatës

"Renesansa". Më 16.10.2025, ligjëratë ndërgjegjësuere në SH.F.M.U. "ZENUN ÇOÇAJ" Gjonaj. Më 17.10.2025, ligjërata në Sh.F.M.U. "METO BAJRAKTARI" Reçan dhe në organizatën Concordia Prizren. Më 20.10.2025 aktivitet për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në Shadërvan. Më 22.10.2025, ligjëratë në SH.F.M.U. "MOTRAT QIRIAZI" Prizren. Më 23.10.2025, ligjërata në SH.F.M.U. "FADIL HISARI" dhe "IBRAHIM FEHMIU" Prizren. Më 24.10.2025, ligjëratë në SH.F.M.U. "DËSHMORËT E ZHURIT" Zhur. Më 27.10.2025, ligjëratë në SH.F.M.U. "LEKË DUKAGJINI" Prizren.

Ehosonografia, Rëtgeni, Mamografia dhe Pap Testi janë realizuar pa pagesë për qytetarët dhe gratë e rajonit të Prizrenit, në kuadër të aktiviteteve institucionale parandaluese dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje. Vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2025 janë realizuar mbi 400 mamografi dhe mbi 180 Pap Teste.

Drejtorja e Shëndetësisë është e hapur për të gjitha bashkëpunimet me organizatat qeveritare, joqeveritare dhe individuale, ndër to veçojmë bashkëpunimin me: Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve, Organizatat "Nëna Terezë", Caritas Kosova, AQH, PREDAPlus, etj.

Ndërtimi i QKMF-së të ish kampi i KFOR-it, është në fazën përfundimtare, po bëhen përgatitjet e fundit dhe pritet të funksionalizohet brenda vitit 2026.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, Drejtorja e Shëndetësisë është karakterizuar edhe nga monitorimi i vazhdueshëm i institucioneve shëndetësore publike dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, koordinimi i aktiviteteve parandaluese dhe promovuese të shëndetit publik, mbështetja e zhvillimit profesional të stafit shëndetësor përmes trajnimeve, menaxhimi i çështjeve administrative dhe teknike, raportimi dhe analizimi periodik i të dhënave shëndetësore për planifikim më efikas të ndërhyrjeve shëndetësore, si dhe planifikimi i projekteve për vitin e ardhshëm.

Stafi i punësuar sipas gjinisë: Në administratën e Drejtorisë së Shëndetësisë aktualisht janë të punësuar/a 6 femra dhe 2 meshkuj, ndërsa në njësinë tonë në QKMF janë të punësuar/a 256 femra dhe 190 meshkuj.

PYETJET E PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS  
“BARAZIA NË FOKUS”

*Jakup Kastrati*

Pyetje: A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim apo takim me tematikë të barazisë gjinore dhe të buxhetimit gjinor?

***Përgjigje: Po kemi marrë pjesë dhe e njohim relativisht mirë politikën e buxhetimit gjinor.***

Pyetje: Cilat aktivitete janë realizuar me qëllim të përfshirjes së Buxhetimit të përgjegjshëm gjinor?

***Përgjigje: Gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2026, kemi organizuar një dëgjim buxhetor të veçantë për buxhetimin gjinor.***

Pyetje: A janë marrë parasysh kërkesat dhe propozimet e qytetarëve për hartimin e buxhetimit gjinor për vitin 2026, pas dëgjimit publik buxhetor të mbajtur më 18.07.2025?

***Përgjigje: Janë marrë parasysh kërkesat që kanë ardhur nga qytetarët të pranishëm në dëgjim buxhetor.***

Pyetje: Cilat aktivitete të tjera e karakterizojnë Zyren për Raportim dhe Informim në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025?

***Përgjigje: Të gjithë agjendën e kryetarit, kuvendit dhe komunës në përgjithësi e kemi ndihmuar profesionalisht rreth organizimit të takimeve publike, dëgjimeve buxhetore, konsultimeve publike dhe buxhetimin me pjesëmarrje.***

Pyetje: Stafi i punësuar sipas gjinisë: Sa femra dhe sa meshkuj janë të punësuar në Zyren e Juaj?

***Përgjigje: Njësia për Komunikim me Publikun ka të angazhuar 7 zyrtarë: 5 femra dhe 2 meshkuj.***

Pyetje: A kanë marrë pjesë zyrtarët/et e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në ndonjë trajnim apo punëtori me tematikë të barazisë gjinore dhe të buxhetimit gjinor?

***Përgjigje: Zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë marr pjesë në punëtoritë të cilat janë organizuar për tematikat e barazisë gjinore (16.06.25).***

Pyetje: Cilat projekte i ka subvencionuar Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2025 në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural?

***Përgjigje: Në vitin 2025 Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka subvencionuar projektet: Ngritja e pemishteve me pemë të imëta, ngritja e pemishteve me pemë arnore, furnizimi me mekanizëm bujqësor, prodhuesit e qumështit, hapja e puseve për ujtiën e tokave bujqësore.***

Pyetje: A ka mbështetë Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gra fermere të rajonit të Prizrenit me subvencione nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural?

***Përgjigje: Në të gjitha projektet e subvencionuara nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë përfituar edhe gratë, por numri i aplikuesve të kësaj gjinie është i vogël.***

Pyetje: Cilat aktivitete të tjera e karakterizojnë Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025?

***Përgjigje: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka zhvilluar edhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me avancimin e pozitës së fermerëve në menaxhimin e fermave, ngritjen e standardit të fermës dhe ekonomive familjare.***

# HISTORI SUKSESI - TRINGË KASEMI

## PYETJET E PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”

### 1. Biografia e shkurtër



*Tringë Kasemi, e lindur në Prizren, është një aktiviste e angazhuar prej më shumë se 15 vite sh në shoqëri civile, me fokus të veçantë në të drejtat e njeriut, barazinë*

*gjinore, përfshirjen e komuniteteve, politikat lokale, transparencën dhe llogaridhënien.*

*Studimet bachelor i kreu në Fakultetin Juridik, ku ndërtoi themelet e njohurive të saj në drejtësi, të cilat më vonë i vazhdoi përmes studimeve dhe trajnimeve profesionale në Qeverisje Lokale dhe të Drejtat e Njeriut, ku zgjeroi njohuritë dhe aftësitë e saj në fusha që lidhen me politikat lokale, qeverisjen demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Studimet dhe poashtu përvoja profesionale e orientuan drejt angazhimit të vazhdueshëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, politikat lokale, kryesisht sociale, dhe aktivizimin e përditshëm si domosdoshmëri.*

*Gjatë rrugëtimit në organizatat e shoqërisë civile, Tringa ka qenë pjesë e iniciativave të shumta në nivel lokal dhe vendor, duke punuar në projekte që synojnë fuqizimin e grave, rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe mbështetjen e komuniteteve të marginalizuara, duke ndërtuar partneritete dhe rrjetëzime, për të avokuar dhe për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për sfidat sociale, me të cilat ballafaqohen qytetarët/et.*

*Pozicionimi i saj brenda shoqërisë civile përfshin hartimin dhe zbatimin e projekteve avokuese, hulumtuese dhe edukative që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit, forcimin e kapaciteteve të të rinjve dhe grave, si dhe përmirësimin e*

*politikave publike, kryesisht në nivel lokal.*

*Për të vazhduar përkushtimin edhe më afatgjatë dhe vizionin për një shoqëri më të drejtë e më gjithëpërfshirëse, ajo në vitin 2023 themeloi organizatën jo-qeveritare “Qendra për Barazi dhe Drejtësi”, organizatë e cila si mision kryesor ka mbrojtjen, promovimin dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë si dhe grupet e marginalizuara, ku edhe sot vazhdon të angazhohet në këtë kauzë.*



2. Sa vite mirreni me aktivizëm qytetar në fushën e barazisë gjinore në Prizren?

*Mbi 15 vite, dmth që nga fillet e angazhimit në shoqëri civile dhe aktivizëm qytetar.*

3. A merrni pjesë në mbledhjet e Komunës së Prizrenit me tematikë të barazisë gjinore, sidomos në mbledhjet e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyres për Barazi Gjinore, Drejtorinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të tjera?

*Kur ato organizohen dhe thirren nga ana e Komunës së Prizrenit, çdo herë kam marrë pjesë, poashtu edhe kam inicuar takime të tilla, me ndarje të ideve dhe marrje të iniciativave të ndryshme të cilat mendoj se ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e vajzave dhe grave dhe avansojnë barazinë gjinore në Prizren.*

4. Përvojat paraprake në punë

*Përvoja paraprake e imja është në organizata të shoqërisë civile, në pozita kryesisht menaxheriale në fushat sociale, poashtu edhe si eksperte e jashtme për ndërtim dhe zhvillim politikash në nivel lokal, hulumtime etj.*

## HISTORI SUKSESI - TRINGË KASEMI

5. Historiku (data e themelimit) të Qendrës për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

*Qendra për Barazi dhe Drejtësi është themeluar në vitin 2023 me qëllim të mbrojtjes, promovimit dhe mbështetjes së të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë dhe gjithë grupet e marginalizuara.*

6. Vizioni i “Qendrës për Barazi dhe Drejtësi”, Prizren

*Shoqëri e barabartë në edukim, punësim e vendimmarrje, jetë pa dhunë në baza gjinore e dhunë në familje dhe barazi gjinore në të gjitha sferat e jetës.*

7. Misioni i “Qendrës për Barazi dhe Drejtësi”, Prizren

*Mbështetja, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë, integrimi i barazisë gjinore në politika publike dhe edukimi i mirëfilltë në çështje gjinore, avansimi i të drejtave të vajzave dhe grave si dhe fuqizimi ekonomik i tyre.*

8. Funkcioni i juaj në Qendrën për Barazi dhe Drejtësi, Prizren;

**Funksioni im në Qendrën për Barazi dhe Drejtësi është themeluese dhe drejtore ekzekutive.**

9. Projektet kryesore të Qendrës për Barazi dhe Drejtësi, Prizren, vitet e realizimit dhe donatorët e tyre

*Projekti kryesor i organizatës “Qendra për Barazi dhe Drejtësi” është i mbështetur nga “Global Fund for Women”, i nisur nga fillimi i vitit 2025, i cili është i fokusuar në programin kryesor të organizatës i cili është “Mbrojtja nga Dhuna me Bazë Gjinore dhe Dhuna në Familje”, pastaj “Fuqizimi i barazisë në vendin e punës: Avancimi i ekuilibrit gjinor” - Bashkimi Evropian e poashtu edhe nga “Caritas Kosova”, në avansim të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe nga “CARE”, i cili pritet të nis dhe që fokusohet në ndryshimet klimatike dhe barazinë gjinore.*

10. Projektet e realizuara gjatë vitit 2025

*“Mbrojtja nga Dhuna me Bazë Gjinore dhe Dhuna në Familje” - Global Fund for Women;*

*“Fuqizimi i barazisë në vendin e punës: Avancimi i ekuilibrit gjinor” - Bashkimi Evropian;*

*“Promovimi i Drejtësisë Sociale dhe Shoqërisë Gjithëpërfshirëse: Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në Prizren” - Caritas Kosova*



11. Planet për të ardhmen

*Organizata “Qendra për Barazi dhe Drejtësi” angazhohet në përditshmëri në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut në Prizren dhe jo vetëm, duke u fokusuar tek vajzat dhe gratë, si grupe të nën-përfaqësuara në çdo sferë të angazhimit të tyre. Organizata, e cila është pothuajse e vetmja organizatë e fokusuar në të drejta të njeriut në përgjithësi e më gjerë në Komunën e Prizrenit, sigurisht se ka planifikime afatgjate, të bazuara në strategjinë pesë vjeçare të organizatës, të cilat realizohen në vazhdimësi dhe pritet të realizohen edhe në të ardhmen, poashtu edhe të zgjerohen programet brenda organizatës.*

*Programi i cili pritet të nis në vitin 2026 është “Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje lokale”, program i cili është më se i nevojshëm të avokohet me fokus, pasi që edhe në programet tjera të organizatës është trajtuar, tani pritet të nis puna me fokus të veçantë.*

## HISTORI SUKSESI - ATER KORO ARIFI

### PYETJET E PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”

#### Biografia e shkurtër



Ater Koro Arifi ka lindur, është rritur dhe është shkolluar në Prizren dhe vazhdon jetën dhe veprimtarinë e saj profesionale në këtë qytet. Përveç angazhimeve të saja, ajo ka bashkëpunuar edhe me vende të tjera.

Ater ka kryer studimet në degën e Pedagogjisë dhe për 8 vite ka punuar në arsim. Gjatë kësaj periudhe ka filluar të merret edhe me mësimdhënien e punimeve të dorës.

Prej 26 vitesh, ajo vazhdon pa ndërprerje të punojë si trajnere e artizanatit, duke u marrë njëkohësisht edhe me prodhim.



Pyetje: Me cilat fusha artizanale merret Ater Koro Arifi?

**Përgjigje:** *Ater Koro Arifi fillimisht është marrë me ngjyrosjen e pëlhurave, ndërsa më pas ka zhvilluar trajnime edhe në fusha të tjera si pikturimi në dru, dizajni i bizhuterive, mozaiku në pasqyrë dhe punimet artizanale të mëndafshit me fshikëza.*

Pyetje: Sa është e angazhuar në ndërmarrësi Ater Koro Arifi?

**Përgjigje:** *Ater Koro Arifi ka dy punëtori me prodhime të saja dhe gjithashtu menaxhon biznese që merren me prodhimin e teknikës së filigranit në argjend, si dhe prodhimin e sapunit.*

*Duke qenë se ka trajnuar një numër të madh njerëzish në artizanate dhe u ka krijuar mundësi pune, ajo është zgjedhur kryetare e Shoqatës së Grave Sipërmarrëse të Kosovës.*



*Ater Koro Arifi është një person që e do shumë Prizrenin dhe nuk mund ta braktisë kurrë atë.*





*Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Prizren*



*Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë, Prizren*



*Panel diskutimi “Gratë që Ndryshojnë Shoqërinë: Diversitet, Fuqizimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna”, OJQ “Sakuntala”, Prizren, 4.10.2025*

**PANAIRI NDËR-RAJONAL I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE TRADITËS  
(4-6.09.2025), OJQ "EQUALITY"**



*Ajshe Spahi, prodhuese e suvenireve*



*Figen Dervish Daka, prodhuese e çantave*



**PANAIRI TRADICIONAL, 2025, 4.10.2025, DTZHE, PRIZREN**



*Fabrika PASTA SANY*



*Ndërmarrja "Liri"*



*Ndërmarrja "Eurofood"*



*Pastiçeria "Beli sweets"*



*Bletaria "ETNIKI", Billushë*



*Asociacioni i Gruas  
"Feminae", Prizren*



*Ergyle Gjurgjealo,  
Panairi i artizanateve, Prizren*



*Badem Arapi, Punim me rruaza*



*Fehmije Kurejshi me koleksionin e saj*



*Çorapë femrash,  
Tregu i grave, Prizren*

*Çorapë femrash, Kukës,  
Republika e Shqipërisë*



*Trajnimi me nxënës "Orientimi në karrierë, 22.10.2025, Prizren*



*Institucioni parashkollor "Zambaku", Prizren*

# FAQJA E FËMIJËVE

**Drejtor:** Lulzim Drini

## VEPRIMTARIA, STRUKTURA DHE AKTIVITETET E INSTITUCIONIT PARASHKOLLOR “ZAMBAKU”, PRIZREN

### 1. Veprimtaria bazike e Institucionit

Institucioni Parashkollor “Zambaku” IP ushtron veprimtarinë e edukimit dhe kujdesit të hershëm për fëmijët e moshës 3-6 vjeç, në përputhje me Kornizën Kurrikulare për Edukimin e Hershëm dhe Parashkollor.

Qëllimi kryesor është krijimi i një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe nxitës për zhvillimin kognitiv, emocional, social, fizik dhe gjuhësor të fëmijëve, në bashkëpunim të ngushtë me familjet dhe komunitetin.

### 2. Paralelet dhe gjuhët e mësimdhënies

Në IP “Zambaku” funksionojnë gjithsej **8 paralele**, të organizuara sipas gjuhës dhe grupmoshave:

- **Në gjuhën shqipe 6 paralele:**
  - 2 paralele për grupmoshën 3-4 vjeç
  - 2 paralele për grupmoshën 4-5 vjeç
  - 2 paralele për grupmoshën 5-6 vjeç
- **Në gjuhën boshnjake 1 paralele**  
(grupmosha 3-6 vjeç)
- **Në gjuhën turke 1 paralele**  
(grupmosha 3-6 vjeç)

### 3. Pjesëmarrja në trajnim për barazi gjinore dhe buxhetim gjinor

Stafii i institucionit, deri në këtë periudhë raportuese, nuk ka marrë pjesë në ndonjë trajnim, punëtori apo program të organizuar me tematikë të barazisë gjinore, diskriminimit gjinor apo buxhetimit gjinor.



### 4. Aktivitetet kryesore në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025

IP “Zambaku” gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025 ka zhvilluar këto aktivitete:

- **Shetitja me tren** aktivitete rekreative dhe motivuese për fëmijët.
- **Shënimi i 7-8 Marsit** Dita e Mësuesit dhe Dita Ndërkombëtare e Gruas, me program të përgatitur nga fëmijët dhe edukatorët.
- **Dita Botërore e Sindromit Down 21 Marsi**, me aktivitete ndërgjegjësuese dhe simbolike.
- **Dita e Autizmit 2 Prilli**, me veprimtari për promovimin e përfshirjes dhe pranimit.
- **Programi lamtumirës** për grupmoshën 5-6 vjeç, si aktivitete përmyllës të vitit parashkollor.

### 5. Struktura e stafit sipas gjinisë

Në IP “Zambaku” janë të punësuar gjithsej 28 punonjës, të shpërndarë sipas gjinisë si vijon: 25 femra dhe 3 meshkuj.

### 6. Përbërja e stafit:

16 edukatore, 5 punëtore teknike (2 në k u z h i n ë , 3 në mirëmbajtje/pastrim), asistente për fëmijët me nevoja të veçanta, 1 psikologe (e angazhuar 2 ditë në javë), 2 punëtorë teknikë (shtëpiaku dhe fokisti/kopshtari), 1 mësuese mbështetëse, Sekretarja dhe Drejtori.

## VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS SË PERSONAVE ME DISTROFI MUSKULARE NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025

### ANTIGONA SHESTAN & RESMIJA RAHMANI: PËRGJIGJE PYETJEVE TË PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”



Pyetje: A keni organizuar ndonjë aktivitet për nder të Ditës Ndërkombëtare të PAK dhe asaj të të Drejtave të Njeriut?

**OPDMK:** *Organizata e Personave me Distrofi Muskulare në Prizren OPDMK ka organizuar aktivitet për shënimin e 3 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe 10 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.*

Pyetje: Cili ka qenë qëllimi i aktivitetit?

**OPDMK:** *Qëllimi i aktivitetit-promovimi i barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe respektimit të të Drejtave të Njeriut në Komunën e Prizrenit.*

Pyetje: Kur dhe ku është mbajtur ky aktivitet?

**OPDMK:** *Aktiviteti është mbajtur më datën 10.XII.2025, në ambientet e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit.*

Pyetje: Në kuadër të aktivitetit, a keni organizuar ndonjë ekspozitë me punime artizanale të PAK?



**OPDMK:** *Në kuadër të aktivitetit është organizuar një ekspozitë me punime artistike të realizuara nga Persona me Aftësi të Kufizuara, me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë nga komunitete të ndryshme, përfshirë komunitetin shqiptar, boshnjak, turk dhe të tjera.*

*Punimet janë rezultat i trajnimeve joformale, veçanërisht në artin në qelq, të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e aftësive krijuese, fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale dhe psikologjike të pjesëmarrësve.*

*Një pjesë e krijimeve janë prezantuar edhe si produkte për t'u shitur gjatë ekspozitës.*



Pyetje: Kush e përkrahu projektin?

**OPDMK:** *Trajnimet dhe ekspozita janë realizuar me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.*

## VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS SË PERSONAVE ME DISTROFI MUSKULARE NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025

**ANTIGONA SHESTAN & RESMIJA RAHMANI: PËRGJIGJE PYETJEVE TË  
PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”**



### **PROJEKTI: DHUNA DIGJITALE NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PAK**

Pyetje: Ju lutem përshkruani shkurtimisht projektin e juaj për dhunën digjitale ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara?



*Gjatë vitit 2025, OPDMK ka zbatuar aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me dhunën digjitale ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara, me theks të veçantë tek vajzat dhe gratë.*

Pyetje: Cili ka qenë synimi i aktiviteteve?

*Projekti synon rritjen e njohurive për format e dhunës digjitale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara për parandalim, raportim dhe reagim ndaj dhunës së b a z u a r n ë t e k n o l o g j i .*



Pyetje: Kush e përkrahu projektin?

*Ky projekt është përkrahur nga East-West Management Institute, në partneritet me Rrjetin e Grupit të Grave të Kosovës RrGK.*

## VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS JOQEVERITARE „SAKUNTALA“ PRIZREN

*Indira Elshani*



### **Historiku:**

Organizata joqeveritare „Sakuntala“ është themeluar në vitin 2008 me qëllim të krijimit të një mjedisi stabil në Kosovë për mes

gjithëpërfshirjes së komuniteteve dhe përfaqësimit të pozitës së tyre në shoqëri, promovimit të drejtave të njeriut me fokus të minoriteteve, promovimit të vlerave të barazisë, përfshirjes sociale, zhvillimit socio-ekonomik për të gjithë individët dhe grupet pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare, gjinore apo shoqërore.

**Vizioni:** Të promovojë në mënyrë aktive jetën dhe iniciativat e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës përmes përfshirjes sociale, të promovojë aktivitete për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore Rome, Ashkali dhe Egjiptian, historinë romë dhe zhvillimin e gjuhës romë, përmirësimin e edukimit të fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptian përmes lëvizjeve dhe veprimeve të ndryshme dhe aktivitete për përmirësimin e shëndetit të tyre, aktivitete nga jeta e përditshme e tyre të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

**Misioni:** Jeta e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, zhvillimi i gjuhës romë, promovimi dhe ruajtja e gjuhës, kulturës dhe historisë, integrimi i grave dhe të rinjve në familje dhe shoqëri, integrimi i fëmijëve përmes edukimit, promovimi dhe përmirësimi i çështjeve shëndetësore dhe iniciativave të përditshme të jetës së komuniteteve, promovimi i të drejtave të grupeve të cënueshme brenda Kosovës dhe ofrimi i shërbimeve dhe angazhimi aktiv i komuniteteve në ndërtimin e rrjeteve të sigurisë sociale. OJQ „Sakuntala“ ka 5 anëtarë.

### **Projektet e realizuara**

Aktivitetet me të rinjtë multi-etnik (aktivitete edukative dhe aktivitete për promovimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore romë):

-Organizata Demokracia për Zhvillim ka mbështetur projektin “Promovimi i vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive“- është mundësuar përmes historisë së suksesit me të rinjtë e komuniteteve pakicë dhe mazhorancë”.

-Organizata HERAS ka mbështetur projektin edukativ “E ardhmja varet nga ajo që ju bëni sot” me të rinjtë RAE minoritarë dhe mazhorancë”.

-Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prizren DKRS ka mbështetur projektin “Ura ndaj diversitetit kulturor dhe dialogu ndërkulturor me të rinjtë minoritarë dhe mazhorancë”.

-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit MKRS ka mbështetur projektin “Diversiteti kulturor në sytë e të rinjve” me të rinjtë minoritarë dhe mazhorancë”.

-MKRS dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE kanë mbështetur projektin “Promovimi i rolit të punës rinore në parandalimin e gjuhës së urrejtjes, ekstremizmit të dhunshëm me të rinjtë minoritarë dhe mazhorancë”.

-MKRS / Departamenti i Rinisë ka mbështetur projektin “Zëri i të rinjve Romë, Ashkali dhe Egjiptian për një të ardhme më të mirë” me synim të rritjes së përfaqësimit të tyre në proceset vendimmarrëse.

-MKRS ka mbështetur projektin “Të bashkojmë komunitetet përmes vlerave kulturore të artit dhe trashëgimisë”.

-DKRS ka mbështetur projektin “Promovimi i vlerave kulturore romë është promovimi i komuniteteve”.

-Ministria e Zhvillimit Rajonal MZHR ka mbështetur projektin „Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe e punësimit të rinjve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Prizren“.

-MKRS ka mbështetur projektin “Arti dhe kultura tek komuniteti etnik rom në Republikën e Kosovës”.

-MZHR ka mbështetur projektin “Rinia e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian për mundësi ekonomike”.

## VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS JOQEVERITARE „SAKUNTALA“ PRIZREN

### *Indira Elshani*

**Aktivitetet me gra dhe vajza rome për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore tradicionale rome përmes artizanatit**

Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Prizren, në bashkëpunim me OJQ-në lokale “Ecma Ndryshe”, DKRS, MKRS dhe UNMIK-u, kanë përkrahur projektin, “Shkathtësitë artizanale drejt pavarësisë së grave dhe vajzave të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Prizrenit”, “Promovimi i vlerave kulturore nga duart e grave dhe vajzave rome”.

Për të përbushur misionin e saj, OJQ „Sakuntala“ ka mbështetur zbatimin e projekteve për përkthimin e librave nga gjuhë të tjera në gjuhën rome dhe aktivitete të tjera si në vijim:

Botimi i magazinës informuese, e botuar në gjuhën rome dhe shqipe, “Yekhipe” “Bashkimi”. Magazina është botuar me mbështetjen financiare të disa organizatave: SOROS, UNHCR, OSBE, SDC, Zyra Ndërlidhëse e Holandës, Komuna e Prizrenit, Caritas Kosova, MKRS.

### **Veprat e përkthyer nga gjuhët e tjera në gjuhën rome**

-Zyra Greke e Ndërlidhjes në Prishtinë ka mbështetur botimin e poezive klasike greke "Iliada" dhe "Odisea" të përkthyer në gjuhën Rome;

-Organizata SOROS ka mbështetur publikimin e romanit "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" nga autori Ismail Kadare.

-Organizatave SDC, SOROS dhe MKRS kanë mbështetur botimin e librit "Publicistika, gjuha rome, kritika letrare".

-MKRS ka mbështetur publikimin e dramës klasike indase "Sakuntala", "Mahabharata" dhe "Valla e rrërrës dhe e hënës".

-USAID /Nisja e Programit të Ndryshimeve Pozitive/ ka mbështetur publikimin e librit "Unë jam e kuqja".

-SOROS ka mbështetur botimin e romanit "1000 Lotosët".

-Zyra e Kryeministrit /Zyra për Çështje të Komuniteteve/ ka mbështetur botimin e romanit "Miliarderi".

### **Panel diskutimi “Gratë që Ndryshojnë Shoqërinë: Diversitet, Fuqizimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna”**



Synimi i takimit: Të fuqizoj rolin e diplomacisë kulturore të udhëhequr nga gratë në ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme dhe

paqësore. Po ashtu synon të theksojë ndikimin e fuqizimit të gruas në parandalimin, identifikimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore duke avancuar një



çasje të koordinuar në mbrojtjen e të drejtave të grave, me fokus ato të komuniteteve pakicë. Paneli është organizuar në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, duke hapur një hapësirë të rëndësishme për diskutim mbi nxitjen e dialogut ndërkulturor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, me fokus të pakicave.

Gjatë panelit janë trajtuar sfidat dhe pasojat e dhunës me bazë gjinore, si dhe rëndësia e reagimit të bashkërenduar institucional, komunitar dhe kulturor. Përmes këtij aktiviteti është synuar të bashkohen ekspertë, përfaqësues institucionalë dhe aktivistë të shoqërisë civile nga të gjitha komunitetet, me qëllim të krijimit të zgjidhjeve të përbashkëta dhe të qëndrueshme. Në panel morën pjesë 30 gra, vajza, burra, përfaqësues të OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Synimi i panelit u realizua, sepse panelistët ishin persona relevant për të prezantuar nevojat, sfidat dhe të arriturat për temën në fjalë. Gjithashtu edhe pjesëmarrësit kanë bashkëbiseduar dhe diskutuar rreth temës në fjalë.

Panelin e financoi MKRS. Panelin e përcollën mediet lokale: “TV Prizreni”, RTK, “Ora Egjiptiane” dhe Radio Prizreni dhe në web faqen: InLajmi.

## VEPRIMTARIA E DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT DKA NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025

### PYETJET E PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”

Pyetje: A ka marrë pjesë stafi punues i DKA në ndonjë trajnim apo takim me tematikë të barazisë gjinore dhe të buxhetimit gjinor?

• ***DKA: Më 20.05.2025, stafi i DKA ka marrë pjesë në punëtorinë me temën “Konsultimi për buxhetimin e ndjeshëm gjinor”, e cila është mbajtur në shkollat e Komunës së Prizrenit.***

Pyetje: Cilat aktivitete janë realizuar gjatë vitit 2025 që përmbajnë mesazhe ose mbështesin barazinë gjinore?

• ***DKA: Më 22.07.2025 është mbajtur takimi i përbashkët i udhëheqëses së NJDNJ dhe zyres për Barazi Gjinore znj. Mybexhele Zhuri me organizatat joqeveritare të Komunës së Prizrenit.***

• ***Më 29.07.2025 është mbajtur takimi i DKA për studime gjinore me Ambasadën Amerikanë dhe Zvicrane në Kosovë.***

• Pyetje: Stafi i punësuar sipas gjinisë: Sa femra dhe meshkuj janë të punësuar në DKA?

• ***DKA: Në DKA janë 13 të punësuar, prej të cilëve 6 femra dhe 7 meshkuj.***

Pyetje: Cilat aktivitete të tjera e karakterizojnë DKA veçanërisht në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025?

• ***DKA: Më 26.06.2025, në sallën e Kuvendit Komunal të Prizrenit, është mbajtur takimi me sektorin e arsimit, drejtorët e shkollave, inspektoratin dhe policinë e Prizrenit. Janë shqyrtuar: siguria në shkolla, provimi i maturës, provimi i arritshmërisë, vlerësimi i performancës së shkollave, respektimi i hartës zonale për regjistrim të nxënësve, planifikimi i buxhetit dhe raportimi i shpenzimeve të shkollave;***

• ***Me Ministrinë e Shëndetësisë, nëpër shkolla, është realizuar projekti për shëndetin riprodhues, shtatëzënitë e hershme dhe braktisjen e shkollave;***

• ***Më 2.08.2025, në hotel “Premium Park” është realizuar punëtorja “Gjetjet e studimit të kryer nga një kuvendare dhe aktiviste e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, metodologjia dhe qasja (me theks: gratë)”;***



# VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PRANË KOMUNËS SË PRIZRENIT NË VITIN 2025

## PYETJET E PARASHTRUARA NGA REDAKSIA E GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”

Pyetje: Në vitin 2025 a keni subvencionuar projekte në fushën e zejeve, të artizanateve, të veshjeve kombëtare dhe të traditave?

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte**  
**DKRS: Po, kemi subvencionuar me theks të veçantë veshjet kombëtare dhe ruajtjen e traditave. Poashtu kemi mbështetur edhe projekte në fushën e zejeve.**

Pyetje: Në vitin 2025 a keni subvencionuar projekte në fushën e kulturës, artit, karikaturës, si dhe projekte për Ansamble folklorike të qytetit?

**DKRS: Kemi subvencionuar disa nga Ansamblet si vijon: SHKA “Agimi”, AKV “Lidhja e Prizrenit”, SHKA “Malësori”, SHKA “Katarina Josipi”, “Plejada”, “Sarski Behar”. Janë subvencionuar edhe OJQ në fushën e karikaturës (OJQ Xhennet Comics) dhe projekte tjera në fushën e artit dhe kulturës.**

Pyetje: Në vitin 2025 a keni subvencionuar projekte për mbrojtjen e trashëgimisë së Komunës së Prizrenit?

**DKRS: Janë mbështetur projekte për promovimin e trashëgimisë, traditave dhe folklorit.**

Pyetje: Në vitin 2025 a keni subvencionuar projekte të grave sportiste të Prizrenit?

**DKRS: Po, janë subvencionuar gjashtë projekte të grave sportiste të Prizrenit.**

I



**Kino Lumi, Festivali i Filmit Dokumentar DOKUFEST, Prizren, 2025**

Pyetje: A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim apo takim me tematikë të barazisë gjinore dhe të buxhetimin gjinor?

**DKRS: Po, kemi qenë pjesë e takimeve dhe dëgjimeve buxhetore me tematikën e buxhetimit gjinor.**

Pyetje: Cilat aktivitete janë realizuar gjatë verës kulturore 2025?

**DKRS: Koncerte, ekspozita dhe gara sportive të ndryshme.**

Pyetje: Cilat aktivitete janë realizuar për festën e Flamurit 28 Nëntori 2025?

**DKRS: Koncerte me shoqëri artistike dhe aktivitete tjera letrare.**

Pyetje: Cilat aktivitete janë realizuar për festat e fundvitit 2025?

**DKRS: Shpallja e Laureatëve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, koncerte dhe organizime tjera.**

Pyetje: Cilat aktivitete të tjera e karakterizojnë DKRS në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025?

**DKRS: Aktivitete kulturore, rinore dhe sportive, festivale, koncerte, shfaqje dhe turnire sportive. Njëkohësisht kanë vazhduar investimet në infrastrukturë sportive dhe kulturore.**



**Festivali i Teatrit në Ambient të Hapur “PRIZREN FEST,” Prizren, 2025**

# FAQJA E KULTURËS

## *Shpresë Siqeca*

### PANAIRI NDËR-RAJONAL I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE TRADITËS

Më 4-6.09.2025, në Sheshin e Dëshmorëve u mbajtë panairi i artizanteve të grave “Mundësitë e barabarta dhe ndryshimi”, i organizuar nga OJQ “Equality” i komunitetit boshnjak të rajonit të Prizrenit.

Në panair morën pjesë artizanet nga Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Malit të Zi (Sjenica, Novi Pazari).

Në panair, nga Prizreni morën pjesë: Shpresa Makasçiu, Badem Arapi, Ergyle Gjurgjealo, Dëshire Dapko, Figen Dervish Daka, Ajshe Spahi etj. Panairi u subvencionua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### PANAIRI TRADICIONAL, 2025 PRIZREN, DTZHE

Panairi tradicional 2025, i cili u mbajtë në Prizren me datën 8.10.2025, u organizua nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik DTZHE.

Panairi u realizua gjatë një dite dhe u mbajtë në dy ambiente të ndryshme.

Në orët e paradites, në Sheshin e Dëshmorëve u prezantuan produktet ushqimore dhe artizanale. Morën pjesë: fabrika për prodhimin e makaronave PASTA SANY, ndërmarrjet “Eurofood”, “Liri”, “n' Fermë”, bletaria “ETNIKI” nga fshati Billushë, bletaria “Zhupa Med” nga fshati Pousko, pasticeria “Beli Sweets” etj. Në panair morën pjesë OJQ “Equality” dhe artizanet: Shpresë Makasçiu, Figen Dervish Daka, Venera Rada, Dëshire Dapko, Alida Miftari, Ergyle Gjurgjealo, Salmena, Zejxhan Celina, Ater Koro, Sejda Ajdini, Medina Smajiq-Kasi etj. Në orët e pasdites, në kejin e Shadërvanit u ekspozuan ushqimet tradicionale ku morën pjesë ndërmarrjet që mirren me prodhimin e ushqimeve tradicionale prizrenase.

Qëllimi i panairit: zhvillimi i ekonomisë vendëse dhe i turizmit të trashëgimisë.

### PROMOVIMI I GAZETËS “BARAZIA NË FOKUS”, NR. 1

*Në vitin 2025, Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Administratës Komunale, botoi dy numra të gazetës “Barazia në Fokus”, me tematikë të barazisë gjinore*

Me datën 22. 07.2025, në Komunën e Prizrenit, në sallën e Drejtorisë së Administratës Komunale, u promovua nr. 1 i gazetës “Barazia në Fokus”.

Promovimin e gazetës e kryesoi Mybexhele Zhuri, udhëheqëse e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore pranë Komunës së Prizrenit. Ajo theksoi se kjo gazetë përmledhë të gjitha përpjekjet dhe aktivitetet në fushën e Barazisë Gjinore të realizuara në Prizren në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025.



Në promovim morën pjesë përfaqësuesit/et e Drejtorive komunale pranë Komunës së Prizrenit, Organizatat Joqeveritare të Komunës së



Prizrenit dhe individët, të cilët bashkëpunuan në realizimin e gazetës.

Gazeta vazhdoi rrugëtimin e saj rreth përgatitjes së numrit 2, e cila përmbledhi aktivitetet në fushën e Barazisë Gjinore të realizuara në Prizren në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Nr. 2 i gazetës “Barazia në Fokus” u botua në fund të vitit 2025.

# TRASHËGIMIA KULTURORE

## *Shpresë Siqeca*

### SHTËPIA E SHANI EFENDIUT

**Vendndodhja** - Shtëpia e Shani Efendiut ndodhet në Qendrën Historike të Prizrenit, në Lagjen e Farkëtarëve. Ndodhet pranë Konakut të Shani Efendiut dhe kinemasë “Lumbardhi”.

**Tipologjia dhe përshkrimi** - Shtëpia i takon tipit të shtëpive me planimetri simetrike dhe qoshk të mbyllur.



Ka bodrum dhe një kat të ndërtuar prej gurësh, tullave të pjekura dhe drurit. Në kat ndodhen hajati, korridori i vogël dhe dhomat. Dy dhomat e pasme janë simetrike në mes vete dhe kanë nga një qoshk të mbyllur, të cilët dalin në formë të erkerit jashtë volumit të dy fasadave anësore. Sot shtëpia është e restauruar dhe në gjendje të mirë. Shtëpia në fillim shërbeu për banim, më vonë për aktivitete politike dhe aktualisht për aktivitete kulturo-artistike.

Më 05.07-05-10.2025, gjatë Autostradës Biennale: “Rrymat që shpalosen: Puls i Kohës”, në shtëpi u hap ekspozita kolektive artistike. Në ekspozitë u prezantua artisti prizrenas Simon Shiroka me punime të filigranit prizrenas të mpleksur me artin modern. Në këto vepra u përdorën paftat e brezit, broshet dhe stolitë e tjera të pasura me motive florale, të kombinuara me fije argjendi dhe gurë ngjyrash të ndryshme. Në ekspozitë u prezantuan edhe pikturat e Alije Vokshit, qeramikat e Anita Muçollit dhe veprat artistike të autorëve të tjerë.

**Vlerat** - Shtëpia bart vlera të arkitekturës qytetare dhe dëshmon kulturën e banimit të shtresës së pasur. Ka vlera historike, kulturore, artistike dhe ambientale.

**Statusi** - Shtëpia është vënë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sporte (2024-2025).

### SHTËPIA E FAMILJES DORAMBARI



**Vendndodhja** - Shtëpia e familjes Dorambari ndodhet në Qendrën Historike të Prizrenit, përballë xhamisë së Gazi Mehmet-Pashës.

**Përshkrimi** - Shtëpia është dykatëshe dhe e kthyer kah rruga. Ajo është e ndërtuar prej gurësh dhe çerpiqëve të lidhur me lloç. Kati është i ndërtuar me skelet druri të mbushur me çerpiqë dhe del jashtë volumit të katit përdhes në formë konsoli. Çatia është e mbuluar me tjegulla të lugëta. Në katin përdhes ndodhen korridori i vogël dhe 2 dhoma. Shkallët janë të shtruara me dërrasa dhe të rrethuara me trabozane druri. Korridori i katit është i ngushtë dhe i shtruar me dërrasa. Në kat ndodhen dy dhoma pranë njëra tjetrës, të cilat janë me madhësi të ndryshme. Dhomat kanë tavane dekorative dhe dollapë prej druri. Fasada është e punuar me plastikë në mur dhe pak ornamente në formë gjeometrike. Sot shtëpia është e restauruar.

Më 05.07-05-10.2025 në Prizren u mbajtë Autostrada Biennale: “Rrymat që shpalosen: Puls i Kohës”. Në kuadër të Autostradës, në shtëpi, pos të tjerëve, artisti Laurent Mareschal prezantoi instalacionin “Beiti” - mozaik me erëza ushqimore.

**Vlerat** - Shtëpia ka vlera arkitektonike, historike, kulturore, artistike dhe ambientale.

**Statusi** - Shtëpia është vënë nën mbrojtjen e ligjit në kuadër të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

## “TIRQIT, OPINGAT DHE PLISI” PJESË TË VESHJEVE IDENTIFIKUESE TË KULTURËS SHQIPTARE”

*Shykran Berisha*

Projekti “Tirqit, Opingat dhe Plisi” - Pjesë të Veshjeve Identifikuese të Kulturës Shqiptare” ka për qëllim dokumentimin, ruajtjen dhe

promovimin e **tirqve, opingave dhe plisit** si elemente të rëndësishme të veshjes tradicionale shqiptare dhe si simbole të identitetit kulturor dhe shpirtëror të popullit shqiptar.

Përmes këtij projekti synohet të analizohet dhe të dokumentohet procesi tradicional i punimit të këtyre pjesëve të veshjes, mënyra e bartjes së tyre në veshjen popullore si dhe rëndësia e tyre historike dhe kulturore në ruajtjen e identitetit kombëtar. Në kuadër të projektit janë realizuar aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe transmetimin e saj tek gjeneratat e reja.

Një nga aktivitetet kryesore ishte organizimi i një **konference shkencore** me pjesëmarrjen e studiuesve dhe njohësve të fushës së etnologjisë dhe trashëgimisë kulturore, ku u diskutua për rolin dhe rëndësinë e veshjeve tradicionale në identitetin kulturor shqiptar. Në kuadër të kësaj konference u organizua edhe një **ekspozitë e modeleve të tirqve, opingave dhe plisit**, duke prezantuar vlera autentike të kësaj tradite.

Po ashtu, projekti përfshiu takime dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë me zejtarët prizrenas, të cilët vazhdojnë të ruajnë traditën e përgatitjes së këtyre elementeve të veshjes. Prosesi i përgatitjes së tirqve, opingave dhe plisit u realizua dhe u dokumentua përmes xhirimeve në punishtet e zejtarëve, duke prezantuar mënyrën tradicionale të punimit nga fazat fillestare deri te produkti final. Këto aktivitete kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e kësaj tradite të rëndësishme artizanale.



Grupi përfitues i projektit përfshin zejtarët dhe sektorin artizanal, shoqëritë kulturore-artistike (SHKA) në Prizren dhe më gjerë, si dhe komunitetin që merret me ruajtjen

dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Përmes këtij projekti synohet që shoqëritë kulturore të përdorin më shumë variante autentike të veshjeve tradicionale të prodhuara nga zejtarët vendorë, duke shmangur përdorimin e produkteve joautentike që nuk përfaqësojnë kulturën tonë.

Rezultatet e projektit pritet të kontribuojnë në **ruajtjen dhe promovimin e elementeve autentike të veshjeve tradicionale shqiptare**, në rritjen e interesimit të të rinjve për të mësuar dhe trashëguar këtë zeje, si dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e sektorit artizanal dhe punësimin e zejtarëve të rinj. Përmes këtyre aktiviteteve forcohet lidhja me traditën dhe identitetin kulturor shqiptar.

Si rekomandim, theksohet nevoja që institucionet dhe organizatat relevante të vazhdojnë të mbështesin ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale, duke ofruar mbështetje për prodhimin dhe promovimin e tirqve, opingave dhe plisit si pjesë të rëndësishme të identitetit kulturor shqiptar.

Ky projekt është mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



## LAJME INFO

### DITËT E SHËN NËNË TEREZËS



Në Prizren, ashtu si në trojet tjera shqiptare, u shënuan Ditët e Shën Nënë Terezës. Hapja solemne u bë më 26.08.2025, në Muzeun e Nënës Terezë, në prani të pjesëmarrësve të shumtë.

Në kuadër të Ditëve, në Muze u mbajtë aktiviteti me fëmijë si dhe u shfaqë një film mbi Shën Nënë

Terezën.

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhemajli Berisha” u shfaqë filmi kushtuar jetës së Shën Nënë Terezës, ku përveç të tjerëve, interpretoi edhe artisti prizrenas me famë botërore Bekim Fehmiu. Më 3.09.2025, në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, u promovuan tre libra të rinj kushtuar Shën Nënë Terezës të autorëve: Don Lush Gjergji, Skender Asani dhe Skender Asani & Albert Ramaj.

Përmes aktiviteteve kulturore, fetare dhe edukative, Ditët shënuan tri data të rëndësishme të jetës dhe veprimtarisë humanitare të Shën Nënë Terezës: lindjen, vdekjen dhe shenjtërimin e saj.

### PUNËTORI ME ASAMBLEISTE DHE ZYRTARE KOMUNALE TË PRIZRENIT

Më 13-14.11.2025, u mbajtë punëtorja dyditore në kuadër të projektit “Autoritete lokale më të forta përmes rritjes së kapaciteteve të asambleistëve dhe zyrtareve komunale në Prizren dhe komunat përreth”. Punëtorja u organizua nga Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me AZHR-Jug dhe me mbështetjen e Këshillit të Evropës. Në aktivitet morën pjesë gra asambleiste nga të gjitha subjektet politike dhe zyrtare komunale, ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë në qeverisjen lokale, duke ndarë përvoja dhe praktika të mira që kontribuojnë në transparencë dhe barazi. Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të rolit të grave në politikën lokale.

### SHOQATA RAJONALE E TË SHURDHËRVE, PRIZREN

Shoqata Rajonale e të Shurdhërve vepron në ndërtesën, e cila gjendet në Lagjen e Terzimahallës, dhe është pronë e Komunës së Prizrenit. Ndërtesa është Monument i trashëgimisë kulturore, për arsye se në fillim ka shërbyer si kinema e parë e Prizrenit. Në vitin 2021 ajo është restauruar nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit MKRS.

Shoqata është e organizuar në tre seksione: seksioni i burrave, i grave dhe i të rinjve.

Gjatë ditës dhe në mbrëmje, anëtarët e shoqatës mblidhen dhe argëtohen duke luajtur shah dhe lojëra të tjera.

Gjatë Javës Ndërkombëtare të të Shurdhërve, Shoqata organizon aktivitete të ndryshme. Në Shoqatë gjithashtu mbahen trajnime për mësimin e gjuhës së shenjave.

Shoqata bashkëpunon me OJQ-të e qytetit, sidomos me OJQ-të e Personave me Aftësi të Kufizuara PAK. Ajo është anëtare aktive e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës “RrGGK”.



## LAJME INFO

### FESTIVALI PËR FËMIJË “DREAM FESTIVAL”

Me datën 2.07.2025, në Sheshin “Ismet Jashari-Kumanova” në Prizren, u mbajtë festivali për fëmijë “Dream festival-Edhe Prizreni ka Disney”.

Festivalin e karakterizoi programi zbavitës me humor, maskota, dhurata dhe fishekzjarre. Festivalin e përcollën fëmijët me prindërit e tyre, si dhe qytetarët dhe turistët e huaj.

Festivali u mbështetë nga Komuna e Prizrenit.

### AUTOSTRADA BIENNALE 2025

Me datën 05.07-05.10.2025, në Prizren u mbajtë Autostrada Biennale: “Rrymat që shpalosen: Puls i Kohës”, i kuruar nga Erzen Shkololli.

Në këtë aktivitet morën pjesë artistë të njohur kosovar dhe ndërkombëtar. Veprat artistike të tyre u prezantuan në Zonën ITP (Qendra për Art Bashkëkohor), Hamamin e Gazi Mehmet Pashës, Muzeun Arkeologjik dhe shtëpitë tradicionale të Shani Efendiut dhe të familjes Dorambari.

Gjatë Bienanales e cila zgjati 3 muaj, kishte dhe programe të tjera të pasura përfshirë takime, biseda etj.

### SHFAQJA TEATRALE “FEMICID”

Me datën 23.08.2025, në kejin e Shadërvanit u shfaqë shfaqja teatrale “Femicid”, me aktorë nga Bosnja dhe Hercegovina, Sanxhaku dhe Kosova.

Shfaqja promovoi barazinë gjinore dhe trajtoi problematikën e dhunës ndaj grave.

Shfaqja u organizua nga SHKA “Sarski Behar”.

### MARSHI SENSIBILIZUES KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT



Për nder të muajit tetor, muaji i vetëdijësimit dhe luftës kundër kancerit të gjirit, Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” është ndriçuar me ngjyrën rozë.

Me datën 1.10.2025, në Prizren u mbajtë Marshi Sensibilizues kundër kancerit të gjirit me moton “Guxim, shpresë, jetë-Ecim së bashku”.

Marshin e organizoi Qendra Komunale e Mjekësisë Familjarë QKMF dhe organizata joqeveritare “Gratë burmesha”. Marshi filloi nga QKMF dhe përfundoi në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në oborrin e Kompleksit u mbajtë një ceremoni ku morën pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, Policia e Kosovës, organizatat joqeveritare, personeli mjekësor, femra të prekura nga kanceri i gjirit etj. Në fjalën e rastit, Dr. Shpresa Llukaj-Goçaj, radiologe në QKMF, theksoi rëndësinë e zbulimit të hershëm të sëmundjes, parandalimin dhe mjekimin.

Qëllimi i marshit: vetëdijësimi i qytetarëve për sëmundjen e kancerit të gjirit.

### BOTIME VIOLETË PIRANA “RRUGËTIMI ROZË”

Me datën 30.10.2025, në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit u promovua libri i Violetë Piranës “Rrugëtimi rozë”. Violetë Pirana është kryetare e OJQ “Renesansa”, e cila veprimtarinë kryesore e ka luftën kundër kancerit të gjirit. Në promovim morën pjesë mjeket e qytetit, femrat e prekura nga kanceri i gjirit, si dhe shoqëria e gjerë civile. Rreth librit diskutuan:

Dr. Shpresa Llukaj-Goçaj, radiologe në Qendrën Komunale të Mjekësisë Familjare, Sadete Sadikaj, drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, Violetë Pirana, autore e librit etj. Libri rrëfen rrugëtimin e autores në luftën kundër kancerit të gjirit.


*Prizreni pitoresk, 2025*



*Autostrada Biennale, Prizren, 2025*



*Simon Shiroka  
Vepër arti*



*Doruntina Basha,  
Gjetje në Hamam*



*Laurent Mareschal,  
Mozaik me erëza*



*Dy çanta artizanale, Studençan*



*Dëshire Dapko, Çantë artizanale*

